



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Financave**  
**Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance**

*Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm*  
*Centralna Jedinica za Harmonizaciju Unutrašnje Revizije – Central Harmonization Unit on Internal Audit*

**Shprehje e interesit të kandidatëve në programin kombëtar të trajnimit  
për certifikim të auditorëve të brendshëm në sektorin publik**

Ministria e Financave – Njësia Qendrore Harmonizuese për auditim të brendshëm së shpejti pritet të filloj me grupin e ri në programin kombëtar për trajnim dhe certifikim të auditorëve të brendshëm në sektorin publik.

Në këtë trajnim për certifikim kombëtar mund të marrin pjesë auditorët e brendshëm të punësuar në sektorin publik dhe të interesuarit tjerë brenda dhe jashtë institucioneve.

**Kandidatët e interesuar që dëshirojnë të ndjekin programin e trajnimit dhe certifikimit  
për auditor të brendshëm, duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:**

1. Të posedojë diplomë universiteti në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet dhe juridik;
2. Përparësi për regjistrim në programin e trajnimit kanë kandidatët të cilët janë të punësuar në subjektin e sektorin publik si auditor të brendshëm para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike e që ende janë të pa certifikuar (neni 23 paragrafi 3);
3. Të gjithë kandidatët që nuk i përkasin pikës së dytë për tu regjistruar në programin e trajnimit do të nënshtrohen provimit pranues në fushën e kontabilitetit dhe auditimit;
4. Testi para kualifikues do të organizohet dhe përgatitet nga NjQH/AB-ja;

**Data e shpalljes për pjesëmarrjen në programin për trajnim dhe certifikim të auditorëve  
të brendshëm është prej 24.07.2019 deri më 02.08.2019**

- Aplikacioni merret në Web faqen e Ministrisë së Financave: [mf.rks-gov.net/](http://mf.rks-gov.net/) Departamenti Qendror Harmonizues i cili së bashku me dokumentet tjera të kërkuara dorëzohen në E-mail adresat: [skender.breznica@rks-gov.net](mailto:skender.breznica@rks-gov.net) dhe [valdet.haziri@rks-gov.net](mailto:valdet.haziri@rks-gov.net) ose mund të dorëzohen edhe në formë fizike në zyrat e Njesisë Qendror Harmonizuese (preferohet që dokumentacioni të dorëzohet në formë elektronike);
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen;

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Kërkesën me shkrim (Formularin e regjistrimit);
- Biografinë (CV);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e Diplomës së Fakultetit;
- Akt-Emërimin ose Kontratën e punës për aplikuesit që i përkasin pikës 2 për plotësimin e kushteve për regjistrim nëse janë të punësuar si auditor të brendshëm në subjektin e sektorit publik;

Për çdo informatë shtesë mund të kontaktoni Njësinë Qendrore Harmonizuese në [telefonat: 038/200-34-138](tel:038/200-34-138) ose [038/200-34-133](tel:038/200-34-133) ose në adresën Rr. “Tringë Smajli” nr.15 (Afër Hotel Siriusit) aneksi i Ministrisë së Financave kati IV zyra nr.32.

Ju mirëpresim dhe ju dëshirojmë sukses.

Me respekt,